



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

PROCESVERBAL
TAKIMI I PËRBASHKËT I
KOMITETIT SEKTORIAL TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
KOMUNIKIMIT
DHE
KOMITETIT TË MIKPRITJES DHE TURIZMIT
(Mbledhja nr. 2)
Mbajtur më datë 30/05/2025

Pjesëmarrës: Hedi Gjoni
Endri Xhina
Hatixhe Bilibashi
Luljeta Dauti
Irena Malolli
Aldo Shehu

Elton Orozi
Rahman Kasa
Anisa Subashi
Gid Shaqiri
Fatos Cerenishti
Mirela Bimo

Në mungesë: Julian Demeti

Matilda Naço
Albin Gega

Të ftuar: Përfaqësues të Risi Albania
Përfaqësues të AKAFPK

RENDI DITËS:

1. Mirëseardhja dhe fjala hapëse

Fjala hapëse u mbajt nga **Znj. Ejvis Gishti**, e cila uroi mirëseardhjen për anëtarët dhe të pranishmit. **Znj. Gishti** tha se, nisur nga diskutimet e mëparshme mes dy sektorëve: TIK dhe Mikpritje dhe Turizëm nuk ka ndërveprim, zhvillimi i këtij takimi të përbashkët është një gur i parë i rëndësishëm i vendosjes së marrëdhënieve të konsoliduara të bashkëpunimit mes tyre. **Znj. Gishti** falënderoi edhe njëherë për pjesëmarrjen dhe ia kaloi fjalën **z. Rahman Kasa**, në cilësinë e kryetarit të KS të Mikpritjes dhe Turizmit.

Z. Kasa tha se, ky takim ishte një mundësi shumë e mirë për të dy sektorët, pasi dhe pse janë sektorë me objektiva të ndryshëm, nuk mund të zhvillohen pa njëri - tjetrin. Turizmi nuk mund ta zhvillojë veten pa digjitalizimin dhe sektori i TIK duhet të shfrytëzojë nevojën e turizmit për zhvillimin e produkteve. **Z. Kasa** tha se, duhet të gjendeshin mënyrat që të ndërtohen aplikacione sa më të thjeshta dhe praktike, sidomos në sektorin e turizmit ku njerëzit nuk janë shumë të përditësuar me zhvillimet teknologjike.

Në vijim fjala i kaloi **z. Endri Xhina** në cilësinë e kryetarit të Komitetit Sektorial të TIK-ut. **Z. Xhina** tha se, ky takim u propozua nisur nga gjetjet e studimit të UNDP që nxirrte në pah mungesën e bashkëpunimit mes dy sektorëve. Studimi tregonte se sektori i turizmit përdor produkte të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të huaja. Ndaj ky takim do të shërbejë për të kuptuar pak më tepër nevojën dhe problematikën, adaptimin e instrumenteve të inteligjencës artificiale dhe aftësitë që nevojiten për përdorimin e këtyre instrumenteve.

Në përfundim të kësaj **znj. Gishti** tha se, gjetjet e studimit të UNDP-së shërbyen si indicie për zhvillimin e takimit të përbashkët, ndaj do të prezantoheshin edhe njëherë shkurtimisht këto gjetje dhe më pas anëtarët mund të diskutonin mbi mekanizmat bashkëpunues. Për prezantimin e gjetjeve e mori fjalën **znj. Aleksandra Kole**.

2. Prezantimi i gjetjeve kryesore të studimit të UNDP Albania për “Ndikimi i digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”

Znj. Kole tha se, në dy takimet e kaluara ishin shpjeguar metodologjia e përdorur për studimin, si dhe gjetjet që kishin dalë nga studimi. Ky takim do të përqëndrohet në një rikujtesë të elementëve kyç të studimit.

Studimi përqëndrohet në tre sektorë prioritarë: energjia, TIK-u dhe turizmi. Në pyetësorin që është bërë për kompanitë, janë marë 100 kompani, nga të cilat 50 nga sektori i turizmit, 30 nga sektori i TIK dhe 20 nga sektori i energjisë. Qëllimi ka qenë për të identifikuar nivelin e digjitalizimit për kompanitë që operonin në këto fusha në Shqipëri.

Znj. Kole shpjegoi se, referuar studimeve ndërkombëtare, nivelet e digjitalizimit për një kompani janë: niveli i parë - pozicionohen ato kompani që kanë infrastrukturë bazë digjitale që mund të jetë interneti, website etj.; niveli i dytë – pozicionohen ato kompani që kanë sisteme të integruara të proceseve; ndërsa në nivelin e tretë dhe të katërt - janë biznese që bazohen në produkte apo shërbime digjitale dhe që përdorin teknologji të avancuara.

Në të njëjtën kohë, projekti identifikoi jo vetëm nivelin e digjitalizimit të kompanive, por dhe qasjen e tyre ndaj profesioneve digjitale. Nga studimi rezultoi se në Shqipëri i jepet fokus shumë i madh profesionit të programuesit duke lënë në mungesë vëmendjeje një sërë profesioneve të tjera digjitale, po kaq të rëndësishme. Krahas kësaj, nga studimi rezultoi se, numri me i madh i kompanive në Shqipëri, janë në nivelin e dytë të digjitalizimit. Dhe pse mund të ketë kompani në nivelin e parë apo të tretë, shifrat nuk janë domethënëse.

Një gjetje e rëndësishme e studimit ishte se të gjitha kompanitë kanë një tendencë për t'u digjitalizuar më tej ose për të përmirësuar shërbimet që ato ofrojnë. Krahas kësaj, nga studimi rezultoi se të gjitha kompanitë ishin të gatshme për të ofruar shërbime më të digjitalizuara. Problematike rezultoi ekspozimi ndaj teknologjive më të avancuara dhe ndaj profesioneve të tjera digjitale përveç programuesit. Një gjetje tjetër e rëndësishme e studimit ishte mungesa e theksuar e bashkëpunimit mes sektorëve. Kjo solli nevojën e zhvillimit të një takimi të përbashkët mes dy Komiteteve Sektoriale.

Znj. Kole tha se, nga studimi ka evidentuar se sektori i turizmit është i uritur për produkte digjitale por priren t'i blejnë ato në kompani të huaja. Kjo mund të vijë si rezultat i mungesës së informacionit ose mungesës së përputhshmërisë mes nevojave të turizmit me produktet e prodhuara nga kompanitë e TIK-ut në vend. Për të kuptuar më shumë mbi këto gjetje dhe reflektuar se cilat mund të jenë zgjidhjet, u mendua zhvillimi i këtij takimi të përbashkët.

3. Diskutim mbi rritjen e bashkëpunimit mes dy sektorëve

Znj. Gishti tha se, sipas ekspertës së UNDP-së mungesa e ndërlidhjes midis sektorëve doli nga takimet që janë bërë me përfaqësues të bizneseve të turizmit.

Z. Kasa tha se, shumica e produkteve që përdoren nga bizneset në turizëm blihen në Maqedoninë e Veriut ose në vendet e tjera të Europës. Ndoshta është e nevojshme të ketë më shumë reklamim, marketing të produkteve shqiptare që të blihen nga bizneset e turizmit. Është e nevojshme të gjenden rrugët e komunikimit dhe prezantimit të këtyre produkteve në treg.

Z. Xhina tha se, e shihte me shumë interes organizimin e një panairi të dedikuar për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në turizëm. **Z. Kasa** tha se, turizmi zhvillonte çdo vit një panair ku merrnin pjesë thuajse të gjitha kompanitë që operojnë në treg. Kompanitë e IT-së mund të bashkohen në këtë panair, ku mund të prezantojnë produktet e tyre në funksion të turizmit, si dhe mund të vendoset bashkëpunimi i drejtpërdrejtë mes palëve.

Në vijim të diskutimeve **znj. Irena Malolli** mori fjalën dhe propozoi që të krijohej një katalog TIK në Shqipëri që t'u shërbente të gjithë sektorëve dhe me kategorizime sipas sektorëve të posaçëm. **Z. Kasa** ndërhyri duke thënë se nuk e shihte me shumë vlerë katalogun por shihte si më të rëndësishëm një aplikacion elektronik ku të përfshiheshin të gjitha palët. **Z. Kasa** tha se, sot ka hotele në Shqipëri që operojnë me operatorë ndërkombëtarë dhe që një aplikacion i tillë do të lehtësonte jashtëzakonisht ndërveprimin mes tyre.

Znj. Malolli tha se, vitin e kaluar Shqipëria përfitoi dy projekte nga programi digjital i Europës, të cilat ofrojnë trajnime falas për digital skills që lidhen me turizmin. **Znj. Malolli** tha se, mund të kontaktonte projektin, në mënyrë që ata të përfshijnë në trajnimet e tyre subjekte të turizmit, lidhur me zhvillimin e këtyre aftësive. Po kështu **znj. Malolli** theksoi se, shumë nga kompanitë që duan produkte nuk dinë ku t'i kërkojnë ose ku t'i gjejnë. Ndaj një katalog me produktet e ofrura dhe kompaninë ofruese lehtëson këtë proces. Këtë ide e mbështeti dhe **znj. Gishti**.

Z. Xhina mori fjalën duke thënë se çdo katalog është i mirëpritur por s' duhet të ngelet vetëm në këtë produkt. Zhvillimi i një forumi ku të përfshihen tre aktorët: bizneset, universitetet dhe qeveria do të ishte një mundësi shumë e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të ofertës. **Z. Xhina** tha se sektori i TIK nuk shpik dot produkte pa u identifikuar dhe përcjellë nevoja nga kompanitë blerëse. Produktet që ekzistojnë sot në treg vijnë si rrjedhojë e një nevojë që ka lindur më përpara dhe është materializuar në një produkt. Ndoshta sot ka oportunitete të reja, sfida të reja, të cilat nuk adresohen me produktet ekzistuese dhe forumi mund të shërbejë si hapësirë për përcjelljen e këtyre nevojave.

Po kështu, **z. Xhina** propozoi që të mendohet dhe punohet për identifikimin e një kualifikimi të ri profesional, që mund të jetë brenda TIK-ut por jo domosdoshmërisht, për të përgatitur një "Innovation specialist". Kjo figurë ndoshta nuk e implementon vetë por është në gjendje të dijë se çfarë mund të bëhet me teknologjinë në mënyrë të përgjithshme, është në gjendje të dijë skemat e financimit, pasi në rastin kur produktet e ofruara lindin si përgjigje apo zgjidhje teknologjike ndaj sfidave apo nevojave të turizmit në Shqipëri mund të konsiderohen si inovacion dhe mund të financohen nga fondet e BE-së apo dhe me fonde të tjera.

Pyetjes së **znj. Gishti** nëse kjo figurë mund të dalë nga arsimi dhe formimi profesional, **z. Xhina** iu përgjigj se po, nuk kishte asnjë pengesë.

Në vijim **znj. Anisa Subashi** tha se, për çdo produkt që krijohet duhet të gjenden mekanizmat për informim dhe reklamim, sepse kjo është e vetmja mënyrë që kompanitë të gjejnë atë që kërkojnë ose ju nevojitet. Ndaj një katalog apo diçka tjetër që do t'i shërbente informimit për këto produkte ishte një zgjidhje shumë e mirë.

Për të vazhduar diskutimin, fjalën e mori **znj. Hedi Gjoni**. **Znj. Gjoni** tha se, ishte plotësisht dakord se ka një mosnjohje reciproke mes sektorëve, produkteve dhe problematikave mes tyre. **Znj. Gjoni** tha se, nxënësit e shkollës që ajo drejton vazhdimisht krijojnë programe ose produkte që mbase mund të shërbejnë për nevojat e kompanive në treg, por që nuk njihen dhe nuk përdoren. Ndaj ideja e krijimit të katalogut informues ose të panaireve të përbashkëta informuese ishte një propozim më shumë vend dhe që do të sillte ndërlidhje mes sektorëve.

Z. Gid Shaqiri mori fjalën duke thënë se, nisur nga eksperiencia e vet ka shumë kompani TIK-u që mund të takojnë bizneset në turizëm për tu ofruar produktet e tyre, por çdo gjë lidhet me benefitet që produkti sjell dhe proceset e punës që ai mund të zhvillojë. Ka raste kur produkti nuk përputhet me kërkesat e biznesit, raste kur përputhet me kërkesat e tyre por ka një çmim të konsiderueshëm ose raste kur biznesi e blen produktin dhe zhgënjehet. Nisur nga kjo situatë më shumë sesa prezantimi i produkteve që janë në treg është e nevojshme informimi për kompanitë ose produktet që janë cilësore në treg. Është e nevojshme që programet që ofrohen në Shqipëri të jenë në nivelin e duhur për t'iu përgjigjur nevojave që ka industria. **Z. Shaqiri** tha se, mbështeste plotësisht idenë e **z. Xhina** për nevojën e një përkthyesi në treg që të lexojë qartësisht nevojën dhe të dijë po ashtu se kush e ofron me cilësi dhe efikasitet produktin që kërkohet.

Z. Kasa tha se, mund të zhvillohej një forum i përbashkët, ku të merrnin pjesë kompani serioze dhe të mëdha që ofronin programe të avancuara, si dhe kompani serioze nga turizmi. **Znj. Gishti** propozoi që ky forum të zhvillohej tek shkolla "Gjergji Canco", meqë drejtoresha e shkollës është anëtare e KS dhe për të promovuar njëkohësisht dhe shkollat e mesme profesionale.

Në vazhdim fjalën e mori **z. Elton Orozi** i cili tha se, industria e turizmit është e segmentuar në shumë sektorë dhe është e ndarë në shumë aktorë për nga niveli apo shkalla e sofistikimit të proceseve dhe aktiviteteve që zhvillohen. Do të ishte shumë efektive që në morinë e këtyre aktorëve, të identifikohen shembuj të mirë të përdorimit të teknologjisë, inovacionit. Po kështu, mund të identifikohen ofrues të shërbimeve që performojnë me një cilësi të lartë, për t'u bërë pjesë e tryezave të përbashkëta në kuadër të vendosjes së kontakteve dhe promovimeve të ndërsjellta.

Z. Orozi theksoi se, në këtë proces shumë të rëndësishme janë shkollat e mesme profesionale, të cilat do të formojnë infrastrukturën e nevojshme njerëzore për të mbuluar ato lloj aktiviteteve apo ato lloj procesesh. Përdorimi i platformave inovative ose teknologjive të avancuara mund të ndihmojë bizneset të reduktojnë kostot, si dhe nevojën për burime njerëzore, një problem kritik ky për bizneset sot. Përdorimi i teknologjisë krijon mundësi dhe hapësira që disa procese të realizohen menjëherë dhe burimet njerëzore të adresohen në sektorë të tjerë.

Z. Fatos Cerenishti mori fjalën dhe tha se, është mëse evidente që turizmi ka shumë nevojë përse i përket teknologjisë së kohës, por vihet re dukshëm që ka mungesë informacioni mbi produktet në treg dhe ofruesit e këtyre produkteve. Ndaj është shumë e rëndësishme të gjenden mekanizmat që informacioni të shpërndahet, të mos mbetet i izoluar, qoftë nëpërmjet takimeve të përbashkëta, qoftë nëpërmjet unioneve dhe shoqatave.

Në vijim fjalën e mori **znj. Hatixhe Bilibashi** e cila tha se, në këndvështrimin e saj panairi apo katalogu janë shumë të rëndësishëm në kuadër të njohjes së ndërsjelltë mes sektorëve dhe ofruesve. Por po kaq e rëndësishme është dhe promovimi i produkteve shqiptare të teknologjisë nga politikbërësit, që të rritet besueshmëria. Një shembull pozitiv i kësaj janë programet e fiskalizimit që aktualisht janë 100% shqiptare.

Znj. Malolli tha se, sugjerimi i saj për krijimin e një katalogu i shërben jo vetëm informimit dhe rritjes së bashkëpunimit mes sektorëve por gjithashtu nxit konkurrencën mes kompanive për të ofruar produkte me cilësi më të mirë dhe kosto më të përballueshme për të qenë konkurrues në treg.

Në përfundim të diskutimeve të anëtarëve **znj. Gishti** mori fjalën për të mbyllur pjesën e parë të takimit. Ajo tha se, ky takim rezultoi shumë i vlefshëm dhe u hodhën ide shumë të mira për të krijuar urat e bashkëpunimit, të cilat do t'i shërbejnë dhe rritjes së shkallës së informimit të bizneseve në treg. **Znj. Gishti** tha se, e shikon të rëndësishme zhvillimin e një forumi të përbashkët mes dy sektorëve. Po kështu, krijimi i një katalogu, ka vlerë sepse e bën më transparent ofertën dhe ndoshta e bën tregun më të lexueshëm nga pikëpamja e produkteve shqiptare që mund të ofrohen. Po ashtu mund të mbahet në konsideratë që në panairin e ardhshëm që zhvillon turizmi të gjendet hapësirë për t'u përfshirë dhe aktorë të TIK-ut. Panairi i radhës mund të shihet më me shumë prioritet, më shumë aktorë të TIK-ut.

Znj. Gishti falenderoi anëtarët për pjesëmarrjen dhe gjithë diskutimet e vlefshme gjatë takimit. Ajo theksoi se takimi vërtetoi një nga gjetjet e studimit të UNDP-së, se ekziston vërtet një gap midis dy sektorëve përse i përket informimit për llojin e produkteve që ofrohen dhe vlera që kanë këto produkte nga pikëpamja e përdorimit në sektor. Nisur nga kjo, ky nuk do të ishte takimi i fundit së bashku.

Për të mbyllur këtë pjesë të parë, **z. Xhina** mori fjalën dhe shprehu kënaqësinë e të qenit në këtë takim të përbashkët. **Z. Xhina** tha se, ky takim shërbeu që të gjithë të hapnin mendjen dhe të kuptonin se ndonjëherë është shumë e nevojshme që gjërat të përkthehen që të jenë të kuptueshme në masë. **Z. Xhina** e mbylli fjalën e vet duke thënë se, shpresonte që ky takim të ishte i pari në vazhdim të një sërë takimesh të tjera në të ardhmen që t'i shërbejnë përkthimit të produkteve sipas nevojave të biznesit.

Në vazhdim të agjendës, Komitetet u ndanë në dy salla sipas fushës së veprimtarisë për të validuar standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale përkatëse.

4. Validimi i standardit të profesionit: “Ndihmës në TIK” dhe “Menaxher i mesëm në hotel dhe restorant”

Në vijim të agjendës, **znj. Aleksandra Kole** filloi prezantimin e draft-it final të standardit të profesionit: “Menaxher i mesëm në hotel dhe restorant”. **Z. Kasa** dhe **z. Cerenishti** sugjeruan të ndryshohej emri i standardit të profesionit në “Asistent menaxher i mesëm” sepse është titull shumë i lartë për një nxënës që sapo ka përfunduar shkollën e mesme. **Znj. Kole** shpjegoi se, grupi i punës ka punuar për funksionet dhe detyrat që duhet të kryejë një menaxher i mesëm në hotel dhe restorant, jo funksionet dhe detyrat që mund të kryejë një nxënës që sapo ka përfunduar shkollën. **Znj. Kole** sugjeroi të prezantonte funksionet dhe detyrat e standardit të profesionit për të vlerësuar më pas ndryshimet e mundshme. Pasi u prezantuan funksionet dhe detyrat për çdo funksion, **z. Shaqiri** tha se ishte plotësisht dakord me standardin e hartuar. Ky vendim u mbështet dhe nga anëtarët e tjerë të Komitetit Sektorial.

Standardin e profesionit “Ndihmës në TIK” e prezantoi **znj. Majlinda Lleshi**. **Znj. Lleshi** shpjegoi për grupin se ishte punuar për një profesionist që përfundon nivelin e II të kualifikimit për TIK. **Znj. Lleshi** prezantoi funksionet dhe detyrat dhe Komiteti validoi dokumentin me disa ndryshime të vogla në formulim, por pa ndryshime përmbajtësore.

5. Validimi i standardit të kualifikimit profesional: “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, niveli II në KSHK dhe “Hoteleri - Turizëm”, niveli IV në KSHK

Pas validimit të standardeve të profesioneve u kalua në diskutimin e standardeve të kualifikimeve profesionale. Anëtarët e sekretariatit teknik prezantuan njësitë e të nxënësve që përmbanin standardet e kualifikimit dhe peshën specifike për çdo njësi të nxënësve. Standardi i kualifikimit profesional “Hoteleri - Turizëm”, niveli IV në KSHK u validua pa ndryshime. Standardi i kualifikimit profesional “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, niveli II në KSHK u validua me disa ndryshime të vogla në formulim, por pa ndryshime përmbajtësore.

6. Përcaktimi i agjendës së radhës dhe fjala përmbyllëse

Sekretariati mbylli takimin duke uruar sezon të mbarë për sektorin e turizmit dhe pushime të mbara për pjesën tjetër, si dhe dakordësuan që për agjendën e takimit të radhës të diskutohej në shtator.

➤ Vendime të marra nga mbledhja:

- Për të forcuar bashkëpunimin mes dy sektorëve u propozua që kompanitë e IT-së t'i bashkoheshin panairit të përvitshëm që zhvillon turizmi, ku mund të prezantojnë produktet e tyre në funksion të turizmit.
- U propozua të krijohej një katalog me produktet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit që prodhohen në Shqipëri që t'u shërbente të gjithë sektorëve, mes tyre dhe turizmit.
- U propozua zhvillimi i një forumi të përbashkët, ku të përfshihen tre aktorët kryesorë: bizneset, universitetet dhe institucionet qeverisëse, për të shërbyer si hapësirë për përcjelljen e nevojave të dy sektorëve.
- U propozua që të mendohet për identifikimin e një kualifikimi të ri profesional, për të përgatitur një “Innovation specialist”.
- U validuan pa ndryshime standardet e profesioneve: ***“Ndihmës në TIK”*** dhe ***“Menaxher i mesëm në hotel dhe restorant”***.
- U validuan pa ndryshime standardet e kualifikimeve profesionale: ***“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”***, niveli II në KSHK dhe ***“Hoteleri - Turizëm”***, niveli IV në KSHK